

U mbajt punëtorja me temën: “Dhuna në familje, pasojat e saj në shoqëri- mekanizmi koordinues kundër dhunës në familje” më datë 29.04.2024 ora 13:00 h, në bashkëpunim me KFOR-in, OSBE-n, dhe anëtarët e mekanizmit komunal kundër dhunës në familje.

Punëtorja me temën “Dhuna në familje dhe Mekanizmi Komunal kundër Dhunës në Familje”, e organizuar nga Ekipi Monitorues Ndërlidhës i KFOR-it (LMT), në bashkëpunim me OSBE-në dhe me mbështetjen e Kryetarit të Komunës, z. Bashkim Ramosaj, u mbajt në shkollën e mesme “Vëllezërit Frashëri”.

Kjo punëtori pati për qëllim të ngritjes së vetëdijes së nxënësve kundër dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore. Parandalimi i këtij fenomeni kërkon organizimin e punëtorive të ngjashme edhe në shkolla të tjera, pasi rastet e dhunës në familje janë rritur në vitet e fundit.

Në punëtori morën pjesë anëtarët e mekanizmit komunal kundër dhunës në familje: Xhavit Nimonaj, Udhëheqës i Njësisë kundër Dhunës në Familje në Stacionin e Policisë; Shefi i OSBE dhe përfaqësuesi të OSBE-së, Ardita Ramizi-Bala, Drejtoreshë e Strehimores në Pejë; Ibrahim Lushaj, Zyrtar në Qendrën për Punë Sociale; Besnik Hulaj, Drejtor për Arsim; dhe Hamid Qorraj, Drejtor i Gjymnazit “Vëllezërit Frashëri”, shefe e kabinetit.

Pjesëmarrësit ndanë informacione të rëndësishme me nxënësit mbi dhunën në familje dhe inkurajuan ata të përhapin mesazhin dhe të raportojnë rastet e mundshme të dhunës.

Këtë aktivitet KFOR-i e mbështeti me sigurimin e pijeve freskuese për pjesëmarrësit që ishin) nxënës të gjymnazit po ashtu ky aktivitet u përkrahë edhe nga komuna e Deçanit

Foto nga aktivitetit. Foto dhe fletëpalosja që u shpërnda pjesëmarrësve



Foto nga aktivitetit i datës 29.04.2024



Dhuna në Familje dhe Mekanizmi Komunal Kundër Dhunës Familjare



Në Komunën e Decanit dhe në të gjithë Kosovën, qytetarët mund të raportojnë rastet e dhunës në familje duke kontaktuar tujt e ndihmës si më poshtë:

Kontaktë Policinë e Kosovës
Nga telefonia fikse dhe mobile: **192** ose **038 550 999**
Te gjitha thirrjet në numrin **080019999** janë anonime, pa pagesë dhe konfidenciale.

Ju mund të dërgoni informatat e juaja edhe në adresën elektronike **Info@kosovopolice.com**

www.kosovopolice.com

www.facebook.com/KosovoPolice

twitter.com/Kosovo_Police

Së bashku për një Kosovë më të sigurt.

Linja Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje:
0800 19 999


Linjë falas dhe aktive 24/7 për të ofruar ndihmë viktimave të dhunës në familje.

Dhuna në Familje dhe Mekanizmi Komunal Kundër Dhunës Familjare



BASHKIM RAMOSAJ

DHUNA NUK ËSHTË KURRË NJË ZGJIDHJE, AS NË FJALË DHE AS NË VEPRË.



Familja duhet të jetë vendi ku ndiheni të sigurt, të respektuar dhe të dëgjuar.

Nëse ndonjëherë ndiheni të frikësuar ose të lënduar, mos kini frikë të flisni.

Ndani ndjenjat tuaja me dikë të besuar – një mësues, një mik, ose një të rritur që ju dëgjon.

Ju keni të drejtë të ndiheni të sigurt dhe të dashur, dhe kurrë nuk është faji juaj nëse dikush sillet keq.

Mbani mend, të tregohesh i fortë nuk do të thotë të godasësh, por të tregosh dashuri, kujdes dhe mirësi.

Le të ndërtojmë së bashku një botë më të mirë, ku çdo fëmijë jeton me buzëqeshje dhe paqe.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA


KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit
Nr. 02 / 2024
Datë: 13.09.2024

PËR/ZA/TO:	<ul style="list-style-type: none">- Faik Jahmurataj- Komandant I stacionit të Policisë në Deçan- Tringa Dreshaj- OSCE- Ajne Iberhysaj – Zyra për barazi Gjinore- Nusret Pepaj- Qendra për Shëndetin Mendor – Pejë- Manjolla Shala-Shefe e Kabinetit- Mon Selmonaj- Anëtar i Asamblesë nga PDK- Teuta Neziraj- Anëtare e Asamblesë nga VV-ja- Albesa Cacaj- Anëtare e Asamblesë nga LDK-ë- Lendita Berisha -Anëtare e Asamblesë nga AAK-ë- Elmedina Sadikaj- Anëtare e Asamblesë nga AAK-ë- Drita Hakaj- Udhëheqëse e Shërbimit Sprovues Pejë- Edona Kameraj-Zyrtare për Informim- Besnik Hulaj- Drejtoria Komunale për Arsim- Agnesa Vokshi – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- Pranvera Pajazitaj- Zyrtare e Prokurimti- Adriatik Likaj- Qendra për Punë Sociale- Ardita Ramizi –Bala – Strehimorja në Pejë- Hajrije Himaj-Hasanmetaj- Zyrtare Administrative në Inspektion
CC:	z. Bashkim Ramosaj –Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Ajne Iberhysaj- Ushtruese Detyrë për Barazi Gjinore
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Procesverbal- punëtorinë e Draft-Strategjisë Komunale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024-2027) dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në familje (2024-2027)

Të nderuar,



U mbajt punëtorja me anëtarët e Mekanizmit kundër Dhunës në familje, anëtarë nga përfaqësuesit e Asamblesë Komonale dhe zyrtarë komunal, me datë 13/09/2024 takimi filloj në ora 13:30h, me temën: Prezantimi i Draft -Strategjisë Komonale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024-2027) dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në familje (2024-2027).

Të pranishëm ishin gjithsej 18 veta. Prezantimin e draft dokumentit Strategjisë Komonale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024-2027) dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në familje (2024-2027) e bëri Koordinatorja e Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje –Ajne Iberhysaj

Pas prezantimit të draft dokumentit të përmendur me lartë, të pranishmit i dhanë sugjerimet dhe plotësimet në draft dokument:

Faik Jahmurataj- Komandant I stacionit të Policisë në Deçan, theksoj koordinimin si masë e domosdoshëm për t'i trajtuar rastet e dhunës në familje dhe gatishmërinë për më qenë pranë çdo qytetari sipas tij Stacioni i Policisë është shërbim në çdo çast.

Ardita Ramizi –Bala – Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës Sigurisë në Pejë, sipas së cilës në draft dokument që është cekur në kapitulli V (Aktivitetet në zbatim të Strategjisë), Fusha e Veprimit- B. Arsimimi dhe informimi objektivi specifik B.2 të aktivitete ku parashihet organizmi i trajnimeve të mësimdhënësve të edukatës qytetare për çështje të dhunë në familje të ndryshohet sipas saj të përfshihen të gjithë mësimdhënësit.

Nusret Pepaj- Qendra për Shëndetin Mendor –Pejë, i cili prezantoi shqetësimin e rastit në fshatin dashinoc si rast që donë trajtim dhe kujdes të theksuar për shkak të gjendjes mentale të renduar ku kërkoj shërbim më të mirë social, sipas tij mungesa e një qendre për trajtim dhe ofrim të trajtimeve të specializuara ku është domosdoshme të ngritet dhe të kërkohet të ndërtohet një qendre e tillë në nivel regjional apo edhe të përgjithshëm si qendër e trajtimit.

I njëjti po ashtu kërkoj të ndërtohet në Deçan një qendër apo hapësirë për qëndrim më gjatë të rasteve të dhunës deri të bëhet integrim apo zgjidhje.

Adriatik Likaj- Përfaqësues i Qendres për Punë Sociale, i cili theksoj për shërbimet e ofruara sa i përket si përgjegjësi që ju takon si qendër kanë qenë të gatshëm dhe kanë ofruar për rastin që u theksuar me lartë fshatit Dashinoc.

Drita Hakaj- Udhëheqëse e Shërbimit Sprovues Pejë, e cila theksoj që është domosdoshme me u angazhuar të gjitha strukturat e ndryshme sipas së cilës e kanë marr si qendër trajtimin e rastit në Dashinoc dhe theksoj se paraqet një rrezikshmëri për rrethin e familje dhe shoqërinë.

Tringa Dreshaj- OSCE, e cila theksoj domosdoshmërinë e hartimit dhe finalizimit të këtij dokumentit strategjikë e njëjta theksoj edhe ndihmësen që të ofroj nga stafi adekuat në kuadër të OSCE-së për Draft-Strategjisë Komonale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024-2027) dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në familje (2024-2027)

Mon Selmonaj – përfaqësua nga radhët e PDK-së; i njëjti theksoj se ku dokument do të ketë mbështetjen për ndarje buxhetore në Asamblenë Komunale sipas tij është shqetësues rastet rritjes së dhunës në familje sipas të dhënave të prezantuara në dokument.

Albesa Cacak - përfaqësua nga radhët e LDK, sipas së cilës rasti i ndieshëm i fshatit Dashinoc duhet të ofrohet banim në qendrën sociale.

Agnesa Vokshi – Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, e plotësoj s erasti i dashinocit kërkon një trajtim më të veçantë qendër ku mund t'i ofrohet shërbim adekuat mjekësor dhe qendra e banimit social nuk e ka këtë mundësi për këtë rast.

Rekomandime:

- Fushata sensibilizuese në shkolla
- Ndërtimi i një qendre regjionale për trajtimin e rasteve të shëndetit mental dhe përdoruesve të substancave psiko-aktive
- Takime me të shpeshta anëtarëve të mekanizmit

Takimin e udhëhoqi Koordinatorja Komunale Kundër Dhunës në Familje, e njëjta e mbajti evidencë me listën e pjesëmarrësve që u nënshkrua nga të pranishmit.

<https://www.facebook.com/profile.php?id=100063777511208>

Takimi përfundoj në ora 15:00

Procesverbal mbajtësja


Ajne Iberhysaj

Ushtruese detyre për barazi Gjinore



